

## **Projekti për Gazsjellësin Trans Adriatik**

**Vendi: Rajonal**

**Numri i projektit: 45690**

**Spektori i Biznesit: Burime Natyrore**

**Tipi i njoftimit: Privat**

**Kategoria mjedisore: A**

**Statusi: Shqyrtimi i Konceptit i Miratuar; Shqyrtimi i Strukturës në Proçes**

**Publikimi i PSD (dokumentit përmbledhës të projektit): 19 Dhjetor 2017**

### **PËRSHKRIMI I PROJEKTIT**

Dhënia e një huaje deri në 500 milionë euro për Gazsjellësin Trans Adriatic AG, ndërtuesi, zotëruesi dhe operatori i Projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik ("TAP" ose "Projekti"). TAP është një gazsjellës gazi natyror ndërkufitar me një gjatësi prej 878 kilometrash, aktualisht në ndërtim, me shtrirje nga kufiri Greko/Turk (në afërsi të Kipoi) deri në Itali (në afërsi të San Foca) pasi përshkon Greqinë, Shqipërinë dhe detin Adriatik. Kapaciteti fillestar i TAP do të jetë 10 miliardë metër kub gaz natyror në vit.

### **OBJEKTIVAT E PROJEKTIT**

Me një shtrirje në pesë vende ku BERZH operon, Korridor i Jugor i Gazit – pjesë integrale e të cilit është edhe TAP – është një projekt i rëndësishëm strategjik i infrastrukturës së gazit që synon të përmirësojë sigurinë dhe diversifikimin e burimeve të energjisë për Europën dhe Turqinë. Ky gazsjellës do të rrisë mundësitë e furnizimit me gaz dhe do të ofrojë rrugë të reja të transportimit të energjisë duke i mundësuar Europës akses në gazin e rajonit Kaspik dhe në afatgjatë edhe më tej përfshirë Mesdheun Lindor, Azinë Qëndrore dhe Lindjen e Mesme.

Si një projekt infrastrukturor ndër-rajonal, Korridor i Jugor i Gazit do të krijojë mundësi për bashkëpunimin ndërkombëtar, integrimin ekonomik dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në rajon. TAP është përfshirë në listën e Komisionit Europian të 33 projekteve prioritare me interesa të përbashkëta të sigurisë së energjisë. Projekte të përmasave të tilla krijojnë gjithashtu mundësi të rëndësishme për bizneset dhe punësimin vendas. Gjatë ndërtimit, Shqipëria dhe Greqia do të përfitojnë rreth 5,000 vende pune (më shumë se 3,000 në Greqi dhe 1,700 në Shqipëri). Ndërtimi i gazsjellësit ka ndikuar në rehabilitimin e 58 km rrugë dhe 42 urave në Shqipëri. Krahas kësaj, TAP ka dakortësuar me qeveritë e secilit vend, të Shqipërisë dhe Greqisë ndërmarrjen e paketave për Investime Mjedisore dhe Sociale përfshirë investime në shëndetësi, transport, dhe në zhvillimin e biznese të vogla dhe të mesme e të sektorit të bujqësisë.

Ndërsa vendet angazhohen në tranzicionin afatgjatë drejt një ekonomie me përdorim të ulët të karbonit, gazi do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm si një hidrokarbur komplementar. Si një hidrokarbur fosil me përmbajtje relativisht të ulët karboni që ofron një burim energjie fleksibël, gazi mund të përdoret për të plotësuar burimet e energjisë së rinovueshme si një rezervë e qëndrueshme kundrejt zgjerimit të burimeve të energjisë së rinovueshme. Shumë prej centraleve të reja termale pritet të furnizohen me gaz për shkak të kostove të ulëta kapitale, fleksibilitetit më të lartë për të vepruar si rezervë ndaj burimeve sporadike të energjisë së rinovueshme dhe emetimit më të ulët të karbonit. Ndërsa energjia e rinovueshme po zgjerohet dhe ndërsa objektivat për reduktimin e emetimeve të gazit në atmosferë bëhen më shtrënguese, gazi si një karburant me përmbajtje të ulët karboni do të ketë një rol të rëndësishëm në gjenerimin e energjisë në lëvizjen drejt një ekonomie të ulët karboni.

## IMPAKTI NË TRANZICION

Impakti në tranzicion i projektit pritet të vijë kryesisht nga kontributi i tij në integrimin dhe ripërtëritjen e tregjeve të energjisë në Europën Jug Lindore.

Projekti do të mbështesë diversifikimin e burimeve të furnizimit me gaz në Europë duke mbështetur ripërtëritjen e sektorit të energjisë në Europën Juglindore. Projekti do të prezantojë dhe konsolidojë praktika rregullatore dhe tregtare si Aksesi i Palëve të Treta dhe produkteve afat-shkurtra, përdorimi i të cilave është i kufizuar në Europën Jug-Lindore.

Gjithashtu, nëpërmjet Projektit, Banka do të angazhohet në politika dialogu për të mbështetur rritjen e kapaciteteve të OST Shqiptare të gazit në fushat ligjore dhe rregullatore. Projekti ka nxitur tashmë një rishikim të detajuar të sistemit të energjisë në Shqipëri duke shkaktuar ndryshime institucionale, rregullatore dhe legjislative. Banka do të eksplorojë edhe nisma të tjera që fuqizojnë institucionet e tregut të energjisë në Shqipëri.

## INFORMACION PËR KLIENTIN

### TRANS ADRIATIC PIPELINE AG

TAP AG është ndërtuesi, zotëruesi dhe operatori i Projektit. Aksionerët e TAP AG përfshijnë BP (Mbretëria e Bashkuar, 20%), Snam SpA (Itali, 20%), SGCC (Azerbaixhan, 20%), Fluxys SA (Belgjikë, 19%), Enagas (Spanjë, 16%) dhe Axpo Trading (Zvicër, 5%).

## PËRMBLEDHJA E FINANCIMIT TË BERZH

500,000,000.00 Euro

## KOSTOJA TOTALE E PROJEKTIT

4,500,000,000 Euro

## PËRMBLEDHJA SOCIALE DHE MJEDISORE

TAP është një zhvillim nga fillesa i cili konsiston në dizenjimin, ndërtimin dhe operimin e një gazsjellësi ndërkuftar prej 878 km për gazin natyror. Rruga e gazsjellësit fillon nga kufiri Greko – Turk dhe përfundon në Itali (afër San Foca) pasi përshkon Greqinë, Shqipërinë dhe detin Adriatik deri në destinacionin final në Itali. TAP do të lidhet në pikën hyrëse të tij me Gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP) në Turqi dhe me rrjetin e gazit natyror Italian të Snam Rete Gas (SRG). TAP është pjesa e fundit e Korridorit Jugor të Gazit, një seri prej katër projektesh (TAP, TANAP, Shah Deniz 2 dhe Zgjerimi i Korridorit Jugor të Gazit që prek 6 vende dhe 3,500 km.

Kapaciteti fillestar i TAP prej 10 miliardë metër kub gaz në vit do të jetë ekuivalent me konsumin e energjisë së rreth 7 familjeve në Europë. Në Greqi, gazsjellësi (me diametër 48”) do të jetë i gjatë 550 km dhe do të fillojë në Kipoi duke mbaruar në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë në jug-perëndim të Leropigisë. Seksioni Grek do të përfshijë një stacion kompresorësh afër Kipoit dhe 22 stacione valvulash bllokimi. Në Shqipëri gazsjellësi do të jetë 215 km i gjatë (me diametër 48”), duke filluar në Bilisht Qendër, në rajonin e Korçës, në kufi me Greqinë deri në pikën e daljes në det 17km në veri-perëndim të qytetit të Fierit (rreth 400 metra në tokë nga fillimi i vijës bregdetare). Një stacion kompresorësh dhe një stacion matës do të ndërtohen në afërsi të Fierit dhe Bilishtit respektivisht edhe 8 stacione të valvulave të bllokimit. Rruga e TAP do të përshkojë pastaj detin Adriatik (me diametër 36”) për rreth 105 km nën det drejt bregdetit Italian. Gazsjellësi në ujrat territoriale italiane do të jetë 25 km i gjatë. Gazsjellësi futet në breg në Italinë jugore përmes një mikrotuneli nën det, në afërsi të qytetit San Foca. TAP përfundon tek Terminali Pritës i Gazsjellësit (PRT) 8.2km në brendësi të tokës ku gazsjellësi lidhet me Snam Rete Gas (SRG). Terminali pritës i gazsjellësit do të shërbejë si qendër e mbikqyrjes dhe kontrollit të TAP. Ajo do të shtrihet në 12 hektarë tokë dhe është projektuar në mënyrë të tillë që të integrohet me territorin rrethues me impakt të kufizuar vizual. Pika e lidhjes me sistemin e Snam Rete Gas do të jetë në kufirin e njësisë së TAP. Në të ardhmen instalimi i dy stacioneve të reja kompresorësh mund të dyfishojë kapacitetin e gjithë sistemit në më shumë se 20 miliardë metër kub nëse do të lindin nevoja për sasi shtesë energjie në rajonin më të gjerë të Kaspikut. Gazsjellësi do të ketë edhe të ashtuquajturën “kundërrjedhje fizike” që lejon gazin nga Italia të devijohet në Europën Jug Lindore nëse burimet e energjisë ndërpriten ose nevojitet kapacitet më i lartë i gazsjellësit për të sjellë gaz shtesë në rajon.

Vlerësimi i Ndikimit Social dhe Mjedisor (ESIA), që mbulon çdo vend (Greqinë, Shqipërinë dhe Italinë) si dhe komponentet e projektit që lidhen me pjesën detare janë përgatitur për TAP nga një konsulent i pavarur mjedisi në përputhje me standartet kombëtare dhe ato të BE (për Greqinë dhe Italinë) dhe janë publikuar në faqen e kompanisë në internet që në vitet 2013-2014. Në vitin 2016 një konsulent i pavarur mjedisor dhe social u angazhua që të asistonte Grupin e Huadhënësve në shqyrtimin dhe krahasimin e projektit me standartet e BERZH (2014) dhe ato të Huadhënësve Kryesorë të tjerë potencialë. Vlerësimi fillestar i konsulentit të pavarur mjedisor dhe social identifikoi fusha ku treguesit mjedisorë dhe socialë duhet të forcoheshin për të përmbushur kriteret e huadhënësve (p.sh. vlerësimi i objekteve përkatëse dhe ndikimet e mundshme kumulative ndërkuftar, përfshirja e Planeve të Angazhimit Mjedisor dhe Social, forcimi i angazhimit të grupeve të interesit dhe mekanizmit të ankesave, parandalimi i impaktit në habitate kritike dhe prioritizimi i karakteristikave të biodiversitetit dhe përmirësimi i procedurave të përdorimit dhe blerjes së tokës).

Si rezultat TAP zhvilloi një Paketë Suplementare të Informimit të Huadhënësve (SLIP) për të adresuar këto çështje dhe për ta strukturuar projektin në përputhje me kriteret e huadhënësve (përfshirë standartet themelore mjedisore të BE dhe Kërkesat e Performancës së BERZH, si dhe Standartet e Performancës së BEI dhe IFC). Këto dy dokumente janë të publikuara në faqen e internetit të BERZH dhe të Kompanisë: ESIAs | SLIP.

Ndërtimi i projektit filloi në mes të vitit 2015 me punime fillestare për rehabilitimin e rrugëve dhe urave në Shqipëri ndjekur nga një lëvrime të tubacioneve në Shqipëri dhe Greqi në tremujorin e 3 dhe 4 të vitit 2016. Punimet në Itali filluan në Maj 2016 në përputhje me Autorizimin e Vetëm të Kompanisë (dhe kishin të bënin kryesisht me sondazhet arkeologjike dhe ato të UXO) ndjekur nga procedurat e përgatitjes të së drejtës së kalimit (ROW) në Shqipëri dhe Greqi gjatë 2016-2017. Bazuar në skedulim aktual, e gjithë faza e ndërtimit pritet të përfundojë në tremujorin e fundit të vitit 2019 për fillimin e kalimit të gazit në vitin 2020. Sipas faqes së internetit të kompanisë, deri në fund të 2017 është përfunduar rreth 58% e projektit .

Për të filluar me ndërtimin, TAP duhet në fillim të sigurojë aksesin në territor përgjatë gjurmës së tij të planifikuar në mënyrë që gazjellësi dhe infrastruktura e lidhur me të, të mund të ndërtohet dhe të vihet në funksionim. Në total projekti prek 19,060 parcela toke: 10,170 në Greqi, 8,700 në Shqipëri dhe 190 në Itali (përfaqësuar nga rreth 45,000 pronarë dhe përdorues tokash). Por, sajë një planifikimi të mirë të gjurmës, nga projekti nuk do të rezultojë asnjë zhvendosje fizike. Një *Udhëzues për Blerjen dhe Servitutin e Tokës* dhe një *Plan për Restaurimin e Bimësisë e Peizazhit* është përgatitur për secilin vend duke konturuar natyrën dhe magnitudën e tjetërsimit të tokës dhe kuadrin e të drjetës së kompensimit dhe asistencës për mirëqënie.

Për të parandaluar impaktin social dhe mjedisor të lidhur me projektin, Kompania ka zhvilluar një Politikë për Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin në përputhje me praktikën më të mira të industrisë. Kjo mbështetet edhe nga një Sistem i fortë i Menaxhimit të Trashëgimisë Mjedisore, Sociale dhe Kulturore i cili është në përputhje me standartet ISO14001:2015, të specifikimit të Organizatës Ndërkombëtare të Standartizimit, dhe Plane të Menaxhimit Mjedisor dhe Social zbatuar në nivelin e projektit nga TAP (Planet e Zbatimit Mjedisor dhe Social) dhe Kontraktorët e tij (Planet e Kontrollit të Kontraktorëve). Këto mbështeten më tej edhe nga dokumenta shtesë të menaxhimit përfshirë Regjistrat e Impaktit Mjedisor dhe Social të Gjurmës së Gazjellësit dhe angazhimet e kompanisë në Investime Sociale dhe Mjedisore.

Zbatimi i këtyre masave mbrojtëse mjedisore dhe sociale është monitoruar nga afër nga Huadhënësit Kryesorë dhe IESC me vizita në të tre vendet në vitin 2016 dhe 2017. Rezultatet e raporteve të monitorimit të IESC (konsulentit të pavarur mjedisor dhe social) nga 2017 në vazhdim do të publikohen në faqen e internetit të Kompanisë.

Synime të tjera të projektit përfshijnë monitorim të vazhdueshëm gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit dhe nxjerrje të raporteve të monitorimit për informacion publik.

Së fundi, një draft Plan Veprimi Social dhe Mjedisor (ESAP) është dakordësuar mes Huadhënësve Kryesorë dhe TAP. Ky plan përfshin masa të ardhshme që Kompania do të duhet të ndërmarrë gjatë ndërtimit dhe operimit. Masat e adresuara në këtë plan përfshijnë por nuk kufizohen me sa mëposhtë:

(i) përditësimi i ESMP-së, nëse nevojitet, përpara operimit

(ii) përfshirja e një Grupi të Pavarur të Jashtëm Monitorimi

(iii) përgatitja e survejimeve shtesë përpara ndërtimeve në ujë për të plotësuar të dhënat ekzistuese

(iv) zhvillimi i një plani kundërveprimi për Menaxhimin e Biodiversitetit ndërtuar mbi strategjinë e mënjanimit të publikuar në SLIP.

TAP do të prodhojë raporte ndërtimi tremujore për Huadhënësit Kryesorë dhe raporte vjetore për performancën kundrejt angazhimeve të projektit dhe Planit të Masave Mjedisore dhe Sociale.

Huadhënësit Kryesorë do të angazhojnë një konsulent të pavarur mjedisor dhe social për të plotësuar monitorimin e Bankës gjatë ndërtimit dhe fillimit të operimit (deri në rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme). Ky konsulent do të kryejë monitorime rutinë gjatë ndërtimit dhe operimit sipas direktivave të Huadhënësve Kryesorë.

Duke qenë se shqyrtimi mjedisor dhe social që ndërmerr Banka është në proces, ky Dokument Përmbledhës i Projektit (PSD) do të përditësohet përpara Bordit.

#### BASHKËPUNIMI TEKNIK

Nuk ka.

#### INFORMACION MBI KONTAKTET E KOMPANISË

Trans Adriatic Pipeline AG

[enquiries@tap-ag.com](mailto:enquiries@tap-ag.com)

+41 41 747 3400

+41 41 747 3401

[www.tap-ag.com](http://www.tap-ag.com)

Lindenstrasse 2 6340 Baar, Sëitserland

Për mundësi biznesi ose prokurime kontaktoni Kompaninë kliente

Për projekte në sektorin shtetëror, vizitoni faqen e prokurimeve të BERZH: Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

#### ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME

Për çështje që nuk lidhen me prokurimet në BERZH kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

#### POLITIKA E INFORMIMIT PUBLIK

PIP përcakton mënyrën se si BERZH jep informacion dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyrë që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj. Ju lutem vizitoni faqen e PIP mëposhtë për tu informuar mbi si mund të kërkonti një Raport të Bordit për Sektorin Publik.

Teksti i PIP mund të gjendet në: <http://ëëë.ebrd.com/about/policies/pip/index.ht>

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankimimeve për Projektet (MAP) për të ofruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata për projektet e financuara nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose që do të shkaktojnë efekte negative mjedisore dhe sociale.

Rregullat e Proçedurës së MAP mund të shihen në:

<http://ww.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Ju mund të kontaktoni për ndihmë stafin e MAP në ([pcm@ebrd.com](mailto:pcm@ebrd.com)) për tu informuar mbi si mund të dërgoni një ankesë. Stafi i MAP është i disponueshëm për tju përgjigjur çdo pyetjeje që ju mund të keni për paraqitjen e një ankesë dhe kriteret për Regjistrim në përputhje me Rregullat e Proçedurës së MAP.